REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:110868

Datë: 11.10.2019

Numri i dokumentit: 00571768

P. nr.321/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal**,** gjyqtarja **Ilirjana Hoti,** me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh.B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II.nr. 604//2019 të datës 21.05.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë **11.10.2019**, në pranin të prokurorit te shtetit Anton Hasanaj, te dëmtuarit P.S. si dhe të akuzuarit Sh.B., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **SH.B.** nga Gjakova, data e lindjes..., i biri i M. dhe i P. e gjinisë Gj., ka te kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës , i martuar atë i 4 fëmijëve, numer personal...

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

-me dt.27.04.2019, rreth orës 15:30, në lagjen B., K.Gjakove, saktësisht ne pompën e derivateve “K.P.” ,i pandehuri Sh.B. me dashje përdor forcën fizike , si rrjedhojë e një gabimi qe i ishte bere ne pompën e derivateve “K.P.” ,ku punëtoret me dt. 26.03.2019 ne vend te naftës i kishin qitur ne veturën e bashkëshortes se tij benzin, atëherë shkon i pandehuri dhe kërkon 180 euro për rregullimin e veturës, kur i pandehuri P.S. si menaxher i pompës i ofron 50 euro për rregullimin e veturës i pandehuri revoltohet ,fillon duke sharë dhe e sulmon fizikisht te dëmtuarin duke e kapur per fyti dhe i ve dy duart ne gjokes dhe e shtyn ,me pastaj largohet nga aty, e nga sulmi ne fjalë i dëmtuari nuk pëson lëndime trupore te dukshme

me çka ka kryer veprën penale te sulmit nga neni 184/1 të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69, 70, si dhe nenit 184 par.1 të KPRK dhe nenit 365 te KPPK-së, -së, të akuzuarit i shqipton;

DËNIM ME GJOBË

Dënim gjobë në shumë prej **300 (treqind) euro**, **,**të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

2019:110869

Nëse dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 44 të KPRK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej 2**0**,- **€(njëzetë).**

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurale të përcaktuara nga gjykata si dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumën prej **30.oo euro** ,në afat prej 15 **ditëve,** pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë ,nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP/II.nr.604/19 të datës 21.05.2019 kundër të akuzuarit Sh.B. nga Gjakova, për shkak të veprës penale sulmit nga neni 184/1 të KPRK-së.

Prokurori i shteti Anton Hasanaj, gjatë shqyrtimit fillestar, lexon aktakuzën PP/II.nr.604/19 dt. 21.05.2019, deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari Sh.B. gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer te cilën e kam në afekt, kërkojë falje nga i dëmtuari dhe premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet ,me te dëmtuarin jemi pajtuar dhe se as me parë e as pas këtij rasti nuk kemi pasur probleme mes veti , andaj i propozoi gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, kërkim falja para gjykatës për veprën e kryer, premtimin se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm, pajtimi me te dëmtuarin si dhe faktin se është hera e pare qe kam ra ne ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë.

I dëmtuari P.S. , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qene se me te njëjtin jemi pajtuar .

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë prokurori i shtetit Anton Hasanaj deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimit te fajësisë ,dhe se aktakuza ka mbështetje ne provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari Sh.B., - **me dt.27.04.2019, rreth orës 15:30,** në lagjen B., K.Gjakove, saktësisht ne pompën e derivateve “K.P.” ,i pandehuri Sh.B. me dashje përdor forcën fizike, si rrjedhojë e një gabimi qe i ishte bere ne pompën e derivateve “K.P.” ,ku punëtoret me dt. 26.03.2019 ne vend te naftës i kishin qitur ne veturën e bashkëshortes se tij benzin, atëherë shkon i pandehuri dhe kërkon 180 euro për rregullimin e veturës ,kur i pandehuri P.S. si menaxher i pompës i ofron 50 euro për rregullimin e veturës i pandehuri revoltohet ,fillon duke sharë dhe e sulmon fizikisht te dëmtuarin duke e kapur per fyti dhe i ve dy duart ne gjokes dhe e shtyn ,me pastaj largohet nga aty , e nga sulmi ne fjalë i dëmtuari nuk pëson lëndime trupore te dukshme

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat , gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e

2019:110869

prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethanë rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzari ka kryer veprën penale te përshkruar ne dispozitiv te aktgjykimit, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetit e te akuzuarit, sjellja e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte dhe asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin , nuk ka qenë i dënuar, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, kërkim falja nga i dëmtuari, pendimin e shprehur për veprën e kryer , premtimin se ne te ardhmen do te jem me i kujdesshëm, deklarimi i të dëmtuarit se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi , të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me gjobë ne shume prej **300 (treqind) euro** , me të cilin dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata nuk ka vendosur për kërkesë pasurore juridike, ngase i dëmtuari P.S., gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike .

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 321/19 më datë 11.10.2019

Sekretarja juridike, **Gj y q t a r j a,**
Flutur Nagavci **Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej **15** ditësh nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

2019:110869